



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 165/5 prot.

Datë 10.02.2026

V E N D I M

Nr. 231/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.02.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga OE “**LIS KONSTRUKSION**” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-70933-12-03-2025, me objekt *“Investime për infrastrukturën e tregjeve, hapësirave tregtare, multifunksionale, rrugë tregtare në zona model zhvillimi, etj. Faza III Rajonet 1&2: “Ndërhyrje për rritjen e ofertës turistike dhe për përmirësimin funksional dhe estetik të bregdetit, Bashkia Durrës” me fond limit 540,893,816.89 (pesëqind e dyzetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e tetëqind e gjashtembëdhjetë presje tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.*

Ankimues:

OE “**LIS KONSTRUKSION**” SHPK me NIPT K66613407H dhe me adresë, Lagjja Minatori, Rruga e Spitalit, Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit me adresë Rr. "Sami Frasheri", nr. 10, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *"Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi ufin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"* i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.12.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-70933-12-03-2025, me objekt “Investime për infrastrukturën e tregjeve, hapësirave tregtare, multifunksionale, rrugë tregtare në zona model zhvillimi, etj. Faza III Rajonet 1&2: “Ndërhyrje për rritjen e ofertës turistike dhe për përmirësimin funksional dhe estetik të bregdetit, Bashkia Durrës” me fond limit 540,893,816.89 (*pesëqind e dyzetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e tetëqind e gjashtembëdhjetë presje tetëdhjetë e nëntë*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Në datën 22.12.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 06.01.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. OE: “CURRI” sh.p.k 452,597,010.04 lekë pa tvsh. Totali i pikëve 268.20 I kualifikuar
2. OE: “FUSHA” shpk, 510,510,510.00 lekë pa tvsh. Totali i pikëve 230.85 I kualifikuar
3. OE “SHKELQIMI 07” shpk vlere 400,000,007.00 lekë pa tvsh. I Skualifikuar
4. OE: “ALBA KONSTRUKSION” shpk 426,631,098.25 lekë pa tvsh I Skualifikuar
5. OE: “AGI KONS” sh.p.k, 419,164,402.06 lekë pa tvsh I Skualifikuar
6. BOE “T & XH” shpk & “2 T” shpk 449,147,650.88 lekë pa tvsh I Skualifikuar
7. BOE “SENKA” shpk & “G.P.G COMPANY” shpk 448,921,105.50 lekë pa tvsh I Skualifikuar
8. BOE. “BESTA” sh.p.k & “TOTILA” sh.p.k 457,829,778.00 lekë pa tvsh I Skualifikuar
9. BOE: “LIQENI VII” shpk & “ULZA” sh.p.k 431,745,088.84 lekë pa tvsh I Skualifikuar
10. BOE: “ERGI” shpk & “BE - IS” shpk 454,575,094.00 lekë pa tvsh
11. OE: “SALILLARI ” sh.p.k 480,000,000.00 lekë pa tvsh I Skualifikuar
12. OE: “PROGEEN” sh.p.k 490,829,400.00 lekë pa tvsh I Skualifikuar
13. BOE "EURONDERTIMI 2000" sh.p.k & “MANE/S" sh.p.k 442,189,223.00 lekë pa tvsh I Skualifikuar
14. OE: “VELLEZERIT HYSA” sh.p.k 445,005,762.32 lekë pa tvsh I Skualifikuar
15. BOE: “RAFIN COMPANY” sh.p.k & “NDREGJONI” sh.p.k 434,811,923.00 lekë pa tvsh I Skualifikuar
16. OE: “BAMI HOLDING” sh.p.k 445,005,762.32 lekë pa tvsh I Skualifikuar
- 17. OE: “LIS KONSTRUKSION” shpk 450,046,687.00 lekë pa tvsh I Skualifikuar**
18. BOE: “PE - VLA - KU” sh.p.k, & “BIBA-X” sh.p.k. 339,894,810.63 lekë pa tvsh I Skualifikuar
19. OE: “JUNIK” sh.p.k 427,379,422.66 lekë pa tvsh I Skualifikuar
20. OE: “EVEREST” shpk 494,443,275.31 lekë pa tvsh I Skualifikuar

II.4. Në datën 15.01.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 05 datë 19.01.2026.

II.5. Operatori ekonomik “**LIS KONSTRUKSION**” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

“Operatori ekonomik “**LIS KONSTRUKSION**” sh.p.k, nuk plotëson Kriterin për Kapacitetin Teknik pika 2.3.1 të Kriteve të Veçanta në DST për objektin: “Investime për infrastrukturën e tregjeve, hapësirave tregtare, multifunksionale, rrugë tregtare në zona model zhvillimi, etj. Faza III rajonet 1&2: “Ndërhyrje për rritjen e ofertës turistike dhe për përmirësimin funksional dhe estetik të bregdetit, Bashkia Durrës.”, për sa i përket “Përvojës së suksesshme në realizimin e punëve të ngjashme,

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë pesë viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës; ose

b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Konkretisht, operatori ekonomik “**LIS KONSTRUKSION**” sh.p.k, nuk plotëson kriterin e punëve të ngjashme sipas kushtit a) Punë të ngjashme (Elementi Natyrë e Ngjashme) për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (në vlerën 270,446,908 lekë pa TVSH) dhe as kushtin b) Punë të ngjashme (Elementi Natyrë e Ngjashme) deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (në vlerën 1,081,787,634 lekë pa TVSH).

Referuar përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik dhe dokumenteve të tenderit, si dhe konceptit të përgjithshëm të prokurimeve, objektet/kontratat e ngjashme, operatorët ekonomik duhet të përmbushin këto elemente:

- *Elementi Kohë:* Kontratat duhet të jenë përfunduar brenda pesë viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

- *Elementi Vlerë:* Madhësia e kontratave duhet të përmbushë kërkesën e autoritetit kontraktor, qoftë 50% apo 200% të vlerës së kontratës që prokurohet.

- *Elementi Natyrë e Ngjashme:* Kontratat duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet. Përmbushja e këtyre kriteve është e domosdoshme për të konsideruar përvojën e një operatori ekonomik si të vlefshme.

Mungesa e përmbushjes së një prej këtyre elementëve (kohë, vlerë, natyrë e ngjashme) e bën të pavlefshme përvojën e paraqitur nga kandidatët ofertues.

Sa më sipër, Operatori ekonomik “**LIS KONSTRUKSION**” sh.p.k, skualifikohet nga kjo procedure”.

II.6. Në datën 20.01.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 165/2026 protokolli, datë 20.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6259 e OE “LIS KONSTRUKSION” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 165/1 prot., datë 21.01.2026 lidhur me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “LIS KONSTRUKSION” SHPK kundërshton me anë të ankimit elektronik me nr. A/2026/6259, dhe me numër protokolli nr. 165/2026 prot., datë 20.01.2026.

II.8. Nëpërmjet shërbimit postar, është dërguar shkresa me nr. 381 prot., datë 29.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 165/2 prot., datë 02.02.2026 me lëndë “Mbi Vendimin e KSHA”, është depozituar nga autoriteti kontraktor infomacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet se e **ka refuzuar atë**.

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “LIS KONSTRUKSION” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij, me pretendimin se: *“Konkretisht, operatori ekonomik LIS KONSTRUKSION sh.p.k, nuk ploteson kriterin e puneve te ngjashme sipas kushtit a) Pune te ngjashme (Elementi Natyrë e Ngjashme) për një objekt te vetëm në një vlere jo më te vogel se 50% e vleres së perlllogaritur te kontratës qe prokurohet (ne vleren 270,446,908 lekë pa TVSH) dhe as kushtin b) Pune te ngjashme (Elementi Natyrë e Ngjashme) deri në nje kufi ku vlera monetare totale e punëve te kryera e marre së bashku është ne nje vlere jo më te vogël se dyfishi i vlerës limit te kontratës që prokurohet (ne vlerën 1,081,787,634 lekë pa TVSH), Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “LIS KONSTRUKSION” SHPK, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, në të cilin parashikohet se *“1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përrjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”*, nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.2. Marrë shkas nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “LIS KONSTRUKSION” SHPK, nga verifikimi i kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, në bazë të të cilit është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se ky kriter 2.3.1 i DST i përmenduar edhe në kriterin e përzgjedhjes së fituesit 4.4 (pika 2, Aftësia organizative dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë), mbi dokumentacionin e kërkuar sipas pikës 2.3.1. të kapacitetit teknik), shkakton konfuzion e paqartësi në mënyrën e përmbushjes së tij, si dhe në vlerësimin e ofertave, konkretisht Komisioni vëren se:

III.1.3. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

“2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Fature tatimore të situacionit përfunditar të deklaruar në organet tatimore
- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi;

Ndërsa:

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto ¹ X

1. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shitesë [0 –10 pikë]

Operatori Ekonomik për të vlerësuar për këtë kriter duhet të provojë se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën të stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike si me poshte:

- Punime për shtrim me beton të lare me sipërfaqe jo më pak se 48,434 m² për kontrata të kryera gjatë tre viteve të fundit

*Përlllogaritja e volumit specifik do të kryhet në varesi në kohezgjatjes së kontratës (data e fillimit të punimeve-data e përfundimit të punimeve) pavarësisht periudhës brenda së cilës janë realizuar këto volume specifike.

* Ky është kriter vlerësimi dhe si i tillë operatorët ekonomik nuk do të skualifikohen por do të vlerësohen, bazuar në sasinë dhe përmbushjen e kushtit të afatit 3 vjeçar. Kriteri është vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës. Vlera e kontratave të mëparshme dhe specifikisht vlera e punime dhe volume të kryera të realizuara, ndikon në disa aspekte të përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë, sikurse janë: i. stabiliteti financiar dhe kapaciteti; -cilësia dhe standardet; -historia e suksesit; -trajtimi i kompleksitetit Për të vlerësuar për këtë kriter operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ekonomik duhet të plotësojë minimalisht vlerën e kërkuar. Nëse kjo vlerë minimale nuk plotësohet do të konsiderohet se operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ka marrë “0” pikë.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2} = O_{k2} \times P_{\max k2} / V_{\max k2}$$

P_{k2} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k2}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e punimeve specifike të kryera)

$P_{\max k2}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

¹Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Permbushja e ketij kriteri do te provohet nepermjet situacioneve perfundimtare, aktit te kolaudit sipas pikes 2.3.1 te Kapacitetit Teknik, dorezimit te detyrueshem te informacionit te permbledhur sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1) dhe cdo dokumentacion provues (sipas rastit) per volumet e kerkuara (leje ndertimi, projekti etj).

Volumet specifike per kontrata te cilat nuk jane kolauduar nuk do te perfshihen ne perlllogartje.

III.1.4. Në nenin Neni 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.1.5. Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm **në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;**
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, **është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i

përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

III.1.6. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “*Për prokurimin publik*” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e

natyrën e kontratës objekt -prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese

III.1.7. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Marrë shkas nga pretendimet e ankimesit, i cili kundërshton skualifikimin e ofertës së tij, nga procedura e prokurimit, me arsyetimin se, nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit lidhur me kontratat e ngjashme (pika 2.3.1 të kapacitetit teknik), KPP vëren se në kriterin e veçantë të kualifikimit pika 2.3.1, autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë, *duhet të paraqesin dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:*

a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës** që prokurohet dhe që është realizuar **gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose*

b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, **është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës** që prokurohet.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me **sektorin publik**, duhet të paraqiten **vërtetime të lëshuara nga një ent publik**, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me **sektorin privat**, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:*

- *Kontratën/at e Sipërmarrjes*
- *Fature tatimore të situacionit përfunditar të deklaruar në organet tatimore*
- *Situacioni përfundimtar*
- *Akt kolaudimi;*

Si edhe në kriterin e përzgjedhjes së fituesit pika 4.4 të DT është kërkuar që:

- *Operatori Ekonomik për të vlerësuar për këtë kriter duhet të provojë se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën të stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike si më poshtë:*

- *Punime për shtrim me beton të lare me sipërfaqe **jo më pak se 48,434 m²** për kontrata të kryera gjatë tre viteve të fundit*

**Përlllogaritja e volumit specifik do të kryhet në varesi në kohezgjatjes së kontratës (data e fillimit të punimeve-data e përfundimit të punimeve) pavarësisht periudhës brenda së cilës janë realizuar këto volume specifike.*

** Ky është kriter vlerësimi dhe si i tillë operatorët ekonomik nuk do të skualifikohen por do të vlerësohen, bazuar në sasinë dhe përmbushjen e kushtit të afatit 3 vjeçar. Kriteri është vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës.....*

Permbushja e këtij kriteri do të provohet nepermjet situacioneve perfundimtare, aktit te kolaudimit sipas pikes 2.3.1 te Kapacitetit Teknik, dorezimit te detyrueshem te informacionit te permbledhur sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1) dhe cdo dokumentacion provues (sipas rastit) per volumet e kerkuara (leje ndertimi, projekti etj).

Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të paraqitura në ankesë për përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitet teknik, arsyen e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor si dhe vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kërkesa për vlerën limit të kontratave-pune të ngjashme, të realizuara është në përputhje me parashikimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e prokurimit publik apo jo. Referuar parashikimeve të nenit 77 të lex specialis si dhe nenit 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, është lënë në të drejtën e autoritetit kontraktor, që për të verifikuar përmbushjen e aftësive teknike të mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë që për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor të kërkojë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave-pune të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ku në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Nga shqyrtimi i hartimit të kriterit të vecantë të kualifikimit 2.3.1 të DT si dhe kriterit të përzgjedhjes së fituesit pika 4.4. e DT, kur kjo kërkesë e fundit do të përmbushet në funksion të dokumentacionit të kërkuar në pikën 2.3.1 të DT, Komisioni konstaton se:

Së pari, mbi mënyrën e hartimit dhe përmbushjes së tyre në plotësim e funksion të njëra-tjetrës, ka një mospërputhje mbi dokumentacionin e kërkuar. Pasi në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik është kërkuar në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me **sektorin publik**, duhet të paraqiten **vërtetime të lëshuara nga një ent publik**, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me **sektorin privat**, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me Kontratën/at e Sipërmarrjes; Fature tatimore të situacionit përfunditar të deklaruar në organet tatimore; Situacioni përfundimtar dhe Akt kolaudimi. Ndërsa në kriterin e përzgjedhjes së fituesit pika 4.4 e DT, përmbushja e këtij kriteri do të provohet nëpërmjet situacioneve përfundimtare, aktit të kolaudimit sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit Teknik, duke shkaktuar konfuzion e

paqartësi në mënyrën e përmbushjes së tij, si dhe në vlerësimin e ofertave, nga ana e autoriteti kontraktor.

Së dyti, referuar pikës 5 të nenit 39, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, është parashikuar që për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon kontrata që janë realizuar gjatë *pesë viteve të fundit*, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ku kjo kërkesë është reflektuar në hartimin e pikës 2.3.1 të kapacitetit teknik në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar, ndërsa në pikën 4.4 të DT autoriteti kontraktor ka kërkuar ... “*vlerësohen, bazuar në sasinë dhe përmbushjen e kushtit të afatit 3 vjeçar*”..., ku në këtë mënyrë janë diskriminuar subjekte të cilat kanë kryer punë të ngjashme në përmbushje të këtij kriteri, përtej afatit 3 vjeçar.

Së treti, referuar pikës 5 të nenit 39, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, është parashikuar që për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon kontratë që është realizuar për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, ku kjo kërkesë është reflektuar në hartimin e pikës 2.3.1 të kapacitetit teknik në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar, ndërsa në pikën 4.4 të DT autoriteti kontraktor ka kërkuar.... “*Punime për shtrim me beton te lare me sipërfaqe jo me pak se 48,434 m² për kontrata të kryera gjatë tre viteve të fundit*”..., ku referuar edhe preventivit pa cmime, pjesë të dokumentave të tenderit, ky zë në pikën [16.Analiza jashtë listë (nr.40. An. Shtrese betoni C20/25 - i larë me agregatë në dukje t=10cm (pedonalja kryesore dhe pasazhet), njësia m³, sasia 4843.4 m³,], ndërsa në kriter është kërkuar dhjetëfishi i këtij volumi, duke i vënë në kushte pabarazie subjekte të interesuara të cilat kanë kryer punime në një vlerë jo më e madhe se dyfishi i vlerës së përcaktuar në zërin e preventivit.

Së katërti, nga verifikimet rezulton se kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik në lidhje me vlerën limit të kontratave-pune të ngjashme të kryera nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2022, e ndryshuar.

Sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi si dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë, në lidhje me vlerën limit të kontratave të ngjashme parashikimet e nenit 39, pika 5 të aktit nënligjor të mësipërm, pasi është në të drejtën e autoritetit kontraktor, hartimi i kriterëve për kualifikimin, por këto të fundit duhet të jenë jodiskriminuese, si dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për prokurimin publik dhe legjislacionin sektorial në fuqi.

Së pesti, marrë shkas nga verifikimi i strukturës së preventivit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, në bazë të të cilit është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se ky preventiv është hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, pasi shkakton konfuzion e paqartësi në mënyrën e përmbushjes së tij, si dhe në vlerësimin e ofertave, konkretisht vëren se:

III.1.8. Autoritetit kontraktor ka ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimit në rubrikën “Dokumentat e tenderit” preventiv pa cmime me përmbajtje si më poshtë vijon:

Objekti: Nderhyrje per rritjen e ofertes turistike dhe per permisisimin funksional dhe estetik te bregdetit

PREVENTIV PUNIMESH

NRL	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI PA TVSH	VLEFTA PA TVSH	TVSH
		1. PUNIME GERMIMI					
1	3.104/b	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet	m3	26305			20%
2	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	21000			20%
		SHUMA 1:					
		2. PUNIME SHITESASH					
3	3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	57521			20%
		SHUMA 2:					
		3. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIME					
4	3.710	F.V. Puseta betoni me Kapak Gize 100x100x100	ml	57			20%
5	3.396	Mbushje me cakelli pas mureve	m3	2138			20%
6	3.401/1	Gjeotekstil me gramature 280 g/m2	m2	69726			20%
7	3.642	Ndertim puseta betoni 1.5x1.5 H=2 m+kapak gize	copë	22			20%
		SHUMA 3:					
		4. PUNIME HEKUR BETONI					
8	2.166	F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	115.71			20%
9	2.182	F.V. Konstrukione metalike te thjeshta.	ton	493			20%
		SHUMA 4:					
		5. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITE					
10	2.196	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 k katrama	m2	1015			20%
11	2.196/b	Hidroizolim me nje shtres astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B	m2	2464			20%
12	2.256/b	Mbulim çatie me panele sanduich	m2	1015			20%
		SHUMA 5:					
		6. PUNIME SHITESASH 2					
13	2.261	Shtrese rere	m3	3250			20%
14	2.267b	Shtrese me pllaka grez importi, 40x40cm	m2	80			20%
15	2.262/4	Shtrese betoni C 16/20	m3	54.3			20%
16	2.280	Shtrese cakelli i imet t=15cm, me cilindrim	m2	69726			20%
		SHUMA 6:					
		7. PUNIME BETONI E BETONARMEJE					
17	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25	m3	988.2			20%
		SHUMA 7:					
		8. ANALIZA TEKNIKE PER PUNIMET DHE INSTALIMET TEKNOLOGJIKE					
18	4.141/a7.0	F.V. Shirit sinjalizimi per kablo 20 kv	m	7500			20%
		SHUMA 8:					
		9. TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA					
19	3.172	F.V. Kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement	copë	15			20%
		SHUMA 9:					
		10. INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE					
20	2.520	F.V. Tub kanalizimi poc Ø 110	ml	1550			20%
21	2.491/1f	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=63mm, t= 7.1 mm, Pn 20	ml	3550			20%
22	2.491/a	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 25	ml	2250			20%
23	2.501	F.V. WC alla frenga	copë	92			20%
24	2.631	F.V. Lavamane porcelani	copë	94			20%
25	2.523	F.V. Tub kanalizimi poc Ø 200	ml	600			20%
		SHUMA 10:					
		11. INSTALIME PER NDRICIM					
26	2.496	F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar, L=1.5m	copë	977			20%
27	2.483	F.V. Celesa e priza 10 A	copë	123			20%
28	2.487	F.V. Kutiderivacioni plastm	copë	64			20%
29	2.487/b	F.V. Kuti suport pllaket 4 mod	copë	28			20%
30	2.485/d	F.V. Priza shuko universal	copë	81			20%
31	2.480/2	F.V. Tub plastmasi Ø 18-21mm	ml	945			20%
32	2.480/3	F.V. Tub plastmasi Ø 22-26mm	ml	355			20%
		SHUMA 11:					
		12. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI					
33	2.328/1	Patinim muri me stuko	m2	4016			20%
34	2.326	Veshje me pllake majolike	m2	175			20%
		SHUMA 12:					
		13. PUNIME BOJATISJE					
35	2.404	Boje hidroplastike	m2	4016			20%
		SHUMA 13:					
		14. PUNIME DYER DRITARE					

36	2.383	F.V. Dyer druri	m2	260		20%
37	2.373/a	Vetrato xhami i temperuar	m2	965		20%
38	2.388	Dyer druri zd kd 1/2 xham	m2	45		20%
SHUMA 14:						
15. NENSHTRESA DHE SHITESA NE TERRITORIN E NDERTESAVE						
39	2.602	Pedane druri (binare+derrese)	m2	10409		20%
SHUMA 15:						
16. ANALIZA JASHTE LISTE						
40	An	Shtrese betoni C20/25 - i larë me agregatë në dukje t=10cm (pedonalja kryesore dhe pasazhet)	m3	4843.4		20%
41	An	F.V. Tub fleksibel me dy shtresa D=90mm (+linja rezerve)	ml	17714		20%
42	An	F.V. Tub fleksibel me dy shtresa D=60mm (+linja rezerve)	ml	17714		20%
43	An	FV Puseta betoni me Kapak Gize 40x40x40cm	copë	150		20%
44	An	F.V.ne toke kablo Cu fuqie +1000V, me izolim gome e mbulose plastmasi, te armaar,5x10mm2	ml	4400		20%
45	An	F.V.ne toke kablo Cu fuqie +1000V, me izolim gome e mbulose plastmasi, te armaar,FROR 4x6mm2	ml	3170		20%
46	An	Shttrim me Rezine	m2	1015		20%
47	An	Shttrim me flete gomine 3 cm	m2	6030.5		20%
48	An	Shttrim betoni i lehtësuar	m3	119		20%
49	An	Manikote f6.3 PN 10	copë	27		20%
50	An	Adaptor DN 63	copë	27		20%
51	An	Mure dopio panel kunder lageshtise 25 cm	m2	1557		20%
52	An	Stol per amfiteater beton me agregate ne dukje h 50 cm	m3	50		20%
53	An	Veshje tavani me pllake gipsi kunder lageshtires	m2	1015		20%
54	An	Rrjete per fushat sportive	m2	67		20%
55	An	Rrjete rrethimi per fushen e futbollit	m2	71		20%
56	An	Profil metalik me diameter 100 mm	ton	0.05		20%
57	An	Panel ndares HPL	m2	282		20%
58	An	Ndricusa pedonal me lartesi 4 m nga toka	copë	290		20%
59	An	Mure ndares me panel dopio kunder lageshtires 15 cm	m2	451		20%
60	An	Tub Corrogato 3x125	ml	9189		20%
61	An	Tub D 400 PVC	ml	1825		20%
62	An	Tub corrogato f 200	ml	3063		20%
63	An	Tub corrogato 2x 125	ml	5620		20%
64	An	Tub corrogato f 63	ml	3429		20%
65	An	Tub Corrogato f 40	ml	4120		20%
66	An	Tub HDPE DN 63	ml	623		20%
67	An	TUB HDPE DN 25	ml	2100		20%
68	An	Shtylla per ndricues ne lartesi 60 cm	copë	175		20%
69	An	F.V pllake dushi	copë	34		20%
70	An	Shtylla per ndricues pedonal me lartesi nga toka 1m	copë	512		20%
71	An	F.V. Pusete plastike me kapak 30x30x30cm	copë	650		20%
72	An	Set Dushi	copë	16		20%
73	An	Set per njerezit me aftesi te kufizuar	copë	12		20%
74	An	Central zjarri konvencional	copë	3		20%
75	An	Pulsant alarm zjarri	copë	3		20%
76	An	Sirene alarmi	copë	3		20%
77	An	Sensor optik	copë	15		20%
78	An	Panel elektrik	copë	12		20%
79	An	Kabeli rjeti Tip FTP cat 5	ml	50		20%
80	An	Kabeli FG160R16 S=3G2.5mm²	ml	355		20%
81	An	Aspirator ne tualete	copë	84		20%
82	An	Kabeli FG160R16 S=3G1.5	ml	705		20%
83	An	Kabeli FG160R16 S=5G2.5mm²	ml	705		20%
84	An	Sensor ndricimi 360 grad	copë	92		20%
85	An	Profile metalike me diameter 80x4,10x10 dhe 5x5	ton	10.3		20%
86	An	Fikse zjarri	copë	30		20%
SHUMA 16:						
17. PAJISJE JASHTË LISTE						
87	Pj	Koka e ndricuesit me lartesi 60 cm	copë	175		20%
88	Pj	Kokat e ndricuesit me lartesi 1m	copë	512		20%
SHUMA 17:						
Shuma Analiza						
SGURIA NË KANTIER (Plani i Sigurisë së Koordinimit në Kantier PSK, Menaxhimi i trafikut dhe kontrolli), min 3%, sipas vendimit nr.216, datë 13.04.2023						
Shuma me PSK						
Fondi Rezervë (5.0%)						
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)						
Shuma TVSH (20%)						
Shuma me TVSH						
Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje)						
Shuma TVSH (për pajisje)						
Shuma Pajisje (me TVSH në shitje)						
Totali						

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____
Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërat në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa vlerë do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomike e detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Në vëmendje formula:

-Çmimi total i Ofertes pa TVSH duhet: [Shuma Analiza + Psk + Fondi Rezerve + Shuma Pajisje (paTVSH ne shitje)

-Çmimi total i Ofertes, me TVSH duhet: [Shuma Analiza + PSK+Fondi Rezerve + vlera TVSH + Shuma Pajisje (me TVSH ne shitje)

III.1.9. Vendim Nr. 610, Datë 22.9.2022 “Për Përcaktimin E Rregullave Të Detajuara Për Mënyrën E Caktimit Të Mbikëqyrësit, Detyrat Dhe Përgjegjësitë E Tij, Kushtet Dhe Elementet E Përgjithshme Të Sigurimit Të Përgjegjësisë Profesionale, Si Dhe Rregullat, Procedurat Dhe Mënyrën E Mbajtjes Së Dokumentacionit Gjatë Zhvillimit Të Punimeve”, në Shtojcën XII të tij pasqyrohet:

OBJEKTI: “ _____ ”

ZBATUESI I PUNIMEVE: “ _____ ” sh.p.k.

Datë: ____/____/____	Nr.	Nr. i analizës	Emërtimi i punimeve të kryera	Njesia	Sasia e punimeve të kryera	Çmimi	Vlefë
Shuma e analizave							
Fondi rezervë deri në 5%							
(vendoset në situacionin përfundimtar në % e përdorur)							
Shuma (Analiza+fondi rezervë)							
TVSH							
Pajisje							
Totali							

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 216 datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, në nenin 5 të tij parashikon se: *“Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë programim të fondeve publike nga buxheti i shtetit apo donatorë të huaj, për efekt planifikimi investimesh për ndërtimin e veprave publike, për të përcaktuar vlerën e fondit limit të veprës orientohen dhe u referohen çmimeve të zërave të punimeve të përcaktuar në sistemin e integruar të manualit të çmimeve të ndërtimit..”*.

Ndërsa në Nenin 6, 7 dhe 18 të tij parashikon :6. *“Hartimi i preventivit apo situacionit, si dhe zbatimi i mbikëqyrjes së çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, me fonde publike ose private, në territorin e Republikës së Shqipërisë, do të bëhet nëpërmjet sistemit të integruar të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.”*.

7.Preventivat për çdo objekt, të hartuara nëpërmjet sistemit të integruar të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në faqen e preventivave të unifikuar në portalin unik qeveritar e-Albania, sipas metodologjisë së llogaritjes së kostos, janë pjesë e dokumentacionit teknik të çdo objekti të projektuar apo të ndërtuar në Republikën e Shqipërisë.

18. Të gjitha detyrimet tatimore ndaj shtetit dhe detyrimet e tjera, të lidhura me veprimtarinë ndërtuese në fushën e ndërtimit, përfshirë sigurimet shëndetësore dhe shoqërore, llogariten sipas vlerave faktike të punimeve, bazuar në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin e çmimeve të ndërtimit, të zbërthyera sipas strukturës së kostos, në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

III.1.10. Referuar preventivit të hartuar nga vetë autoriteti kontraktor, KPP konstaton se punimet e kërkuara janë kategorizuar nga ana e autoritetit kontraktor në Punime Ndërtimi dhe montime, si edhe furnizim i pajisjeve me dhe pa TVSH. Komisioni konstaton, se hartimi i strukturës së preventivit për këtë objekt-prokurimi nuk është hartuar nga autoriteti kontraktor

konform dispozitave ligjore të fushës së ndërtimit (Vendim Nr. 216 datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, në lidhje me formatin e tabelës, kolonat përbërëse të preventivit.

Tabela përmbledhëse e preventivit ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga ana e autoritetit kontraktor është si më poshtë :

PREVENTIV PUNIMESH

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI PA TVSH	VLEFTA PA TVSH	TVSH
1. PUNIME GERMIMI							
1	3.104/b	Germim dhe me ekskavator zingjir, 0.5 m ³ , në kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shik në mjet	m3	26305			20%
2	3.158/5a	Transport dhe me auto deri 5.0 km	m3	21000			20%
SHUMA 1:							
2. PUNIME SHITRESASH							
3	3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	57521			20%
SHUMA 2:							

Ndërsa tabela përmbledhëse e preventivit sipas formatit të preventivit, hartuar në portalin unik qeveritar e-albania, nëpërmjet sistemit të integruar të manualit të çmimeve është si më poshtë:

Vlerat permbledhëse		
Shuma Analiza		0.00
Fondi rezervë 5%		0.00
Shuma (Analiza + Fondi Rezervë)		0.00
TVSH 20%		0.00
Shuma Pajisjet me TVSH		0.00
Totali		0.00

Parë në rrafshin krahasimor, Komisioni konstaton se, në rastin konkret AK, në strukturën e preventivit të hartuar prej saj dhe ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik, me atë të hartuar nëpërmjet sistemit të integruar të manualit të çmimeve, ka përcaktuar një kolonë me emërtimin “TVSH 20%”.

III.1.11. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, ku parashikohet se:

“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenin 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht:

“Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”,

si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, ku parashikohet se:

“[...] Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”,

KPP gjykon se, hartimi i kriterit të kualifikimit dhe ai i përzgjedhjes së fituesit, janë në mospërpurputhje mbi dokumentacionin e kërkuar, i cili përbën shkak për anulimin e kësaj procedure prokurimi, duke krijuar konfuzion mbi përbushjen e tyre dhe i vendos në kushte pabarazie ofertuesit e interesuar.

Gjithashtu, KPP gjykon se, hartimi i strukturës së preventivit jo në përputhje me aktet ligjore/nënligjore në fuqi të legjislacionit të posaçëm të ndërtimit përbën shkak për anulimin e kësaj procedure prokurimi. Në këtë kuptim autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “*Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik*

gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “LIS KONSTRUKSION” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-70933-12-03-2025, me objekt “Investime për infrastrukturën e tregjeve, hapësirave tregtare, multifunksionale, rrugë tregtare në zona model zhvillimi, etj. Faza III Rajonet 1&2: “Ndërrhyrje për rritjen e ofertës turistike dhe për përmirësimin funksional dhe estetik të bregdetit, Bashkia Durrës” me fond limit 540,893,816.89 *(pesëqind e dyzetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e tetëqind e gjashtembëdhjetë presje tetëdhjetë e nëntë)* lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik dhe të dërgojë hard-copy e DTS së re, përpara publikimit.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “LIS KONSTRUKSION” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

